



AVOKATI I POPULLIT



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës,
trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtëruës

Adresa: Bulevardi "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/319
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 202101163/1

Tiranë ___/___/2021

Lënda : *Rekomandim mbi inspektimin e kryer në I.E.V.P. Zahari Krujë më dt. 30.08.2021.*

Drejtuar: Z. Ulsi MANJA
Ministër i Drejtësisë

TIRANË

Znj. Ogerta MANASTIRLIU
Ministër i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

TIRANË

Z. Admir ABRIJA
Drejtor i Përgjithshëm i Burgjeve

TIRANË

Z. Petrit MYSLYMI
Drejtor i I.E.V.P. Krujë

KRUJË

Z. Ded ZHIVANI
Drejtor i I.E.V.P Lezhë

LEZHË

Të nderuar zonja/zotërinj,

Avokati i Popullit në rolin e Mekanizmit Kombëtar për parandalimin e torturës, trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtëruës, në vijim Mekanizmi Kombëtar ka tërhequr në mënyrë të përsëritur vëmendjen për kushtet e trajtimit në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale ku janë vendosur personat me çrregullime të shëndetit mendor që kanë kryer vepra penale ose persona me masë mjekësore mjekim i detyruar. Moszbatimi i ligjit nr. 44/2012, datë 08.05.2012

“Për Shëndetin Mendor”, për ngritjen e një Institucioni të Posaçëm Mjekësor me qëllim trajtimin e kësaj kategorie personash, ka sjellë problematikën e trajtimit të tyre në institucione të ekzekutimit të vendimeve penale, të cilat për më tepër gjenden në kushte mjaft të rënduara amortizimi e mbipopullimi. Institucioni i Avokatit të Popullit në mënyrë të përsëritur ju ka rekomanduar institucioneve përgjegjëse mbylljen e I.E.V.P. Zahari, Krujë ku ata trajtohen më së shumti, dhe ka kërkuar në mënyrë të përsëritur me forcë për ngritjen e institucionit të veçantë të parashikuar me ligj. ***Deri në ngritjen e këtij institucioni, Avokatit të Popullit ka kërkuar përmbushjen e standardeve të kushteve materiale të këtyre mjediseve të lidhura drejtpërsëdrejti me investimet e pamjaftueshme, si dhe ofrimin e një shërbimi cilësor, që mundësohet pikësepari me rritjen e numrit të punonjësve të stafeve mjekësore dhe atyre mbështetëse.***

Referuar rekomandimeve të CPT-së¹ dhe Avokatit të Popullit nga ana Ministrisë së Drejtësisë dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve në vitin 2018 u morr një vendim lidhur me zgjidhjen provizore të kësaj problematike, e cila nisi me rikonstruktimin dhe përshtatjen e dy godinave 4, 5 brenda I EVP-së Shën Koll², Lezhë, të cilat do të shërbejnë për akomodimin provizor të personave të trajtuar në I EVP Zahari, deri në ngritjen e institucionit të posaçëm të parashikuar me ligj.

Në datat 27 dhe 28 nëntor 2021, u krye me sukses procesi transferimit nga I EVP Krujë i 314 shtetasve me masë mjekësore³ dhe akomodimi i tyre në dy godinat në I EVP Lezhë⁴. Sipas informacionit të marrë nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve i gjithë stafi i I EVP Krujë, përfshirë psikiatër, infermierë, punonjës social kujdestarë dhe sanitarë tashmë janë alokuar si kapacitete në dy godinat në I EVP Lezhë, dhe po ushtrojnë funksionin e tyre për trajtimin e specializuar të pacientëve me masë mjekësore.

Numri i stafit që do të trajtojë këtë kategori personash në Lezhë është 35, konkretisht 2 mjekë psikiatër, 1 mjek kardiolog, 1 mjek i përgjithshëm, 2 psikologë, 1 stomatolog, 1 kryeinfermier, 10 infermierë, 5 kujdestarë, 5 sanitarë, 6 punonjës socialë dhe 1 farmacist.

Me transferimin e këtyre shtetasve në I EVP Lezhë, përveç përmirësimit të ndjeshëm të kushteve të banimit, është lehtësuar edhe aksesin e pacientëve në shërbime të specializuara shëndetësore, të cilat do të mundësohen nga shërbimet mjekësore të ambulancave/spitaleve shtetërore.

¹ Në raportin më të fundit të publikuar nga CPT mbi vizitën e kryer në nëntor të vitit 2018 <https://www.coe.int/en/web/cpt/-/council-of-europe-anti-torture-committee-publishes-report-on-alban-në> përmbledhjen ekzekutive CPT/inf (2019) 28 theksohet: “***Situata e pacientëve psikiatrikë në konflikt me ligjin ka qenë objekt i një dialogu të gjatë midis CPT-së dhe autoriteteve shqiptare, duke marrë parasysh që pacientët në fjalë janë mbajtur për shumë vite në kushte të papranueshme dhe me kujdes të pamjaftueshëm psikiatrik në Spitalin e Burgjeve në Tiranë dhe në Institutin e Veçantë të Zaharisë në Krujë...***”

² CPT Report 2018, faqet 7,37,38, si dhe faqja 45 “Administrimi i spitalit të ri në burgun e Lezhës nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale do të mundësojë shërbime të specializuara për këtë kategori, duke bërë të mundur aksesin e këtyre pacientëve në aktivitete kuptimplota jashtë qelive, përkujdesjen e nevojshme njerëzore dhe kontaktin me specialistë (psikiatër, psikologë, kujdestarë)”

³ 217 shtetas me masë mjekësore “shtrim i detyruar” dhe 97 shtetas me masë mjekësore “shtrim i përkohshëm”

⁴ I EVP Lezhë përmes urdhrin Nr. 8927/1, datë 27.09.2018 të Ministrisë së Drejtësisë është klasifikuar Burg i sigurisë së zakonshme, me një seksion të veçantë për trajtimin e shtetasve me masë mjekësore mjekim i detyruar.

Ndërkohë, dy godinat në Lezhë krahas stafit të dedikuar për trajtimin e pacientëve do të kenë edhe ambiente dhe pajisje të dedikuara mjekësore, konkretisht:

- dhomën e infermierisë të kompletuar me medikamentet e urgjencës,
- elektrokardiograme (EKG) dhe defribilator,
- poltron të ri dentar.

Kuadri ligjor e institucional

Në ligjin nr. 44/2012 “Për Shëndetin Mendor”, në nenin 28, pika 1 përcaktohet se: *“Institucionet mjekësore të posaçme janë institucione që shërbejnë për trajtimin e personave me çrregullime të shëndetit mendor që kanë kryer vepra penale për të cilat gjykata kompetente ka vendosur mjekimin e detyruar në një institucion mjekësor, të të paraburgosurve apo të dënuarve që shfaqin çrregullime të shëndetit mendor gjatë vuajtjes së dënimit, si dhe për trajtimin e personave për të cilët gjykata ka vendosur shtrimin e përkohshëm në një institucion të posaçëm në bazë të nenit 239 të Kodit Procedurës Penale”*. Theksojmë se ligji nr. 44/2012 “Për Shëndetin Mendor”, i cili ka hyrë në fuqi në datën 01.06.2012, nuk e kushtëzon zbatimin e dispozitave të tij me ndërtimin apo krijimin e institucioneve mjekësore të posaçme nga Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale.

Në referim të dokumentit “Mbi Rregullat Evropiane të Burgut”, miratuar nga Këshilli i Evropës dhe deleguar për zbatim vendeve anëtare me rekomandimin Nr.87/3, të Këshillit të Ministrave, ndër të tjera në pikën 100.1 të tij, përcakton se: *“Personat që konstatohen me probleme të shëndetit mendor nuk duhet të mbahen në burg, por duhet të dërgohen sa më shpejtë që të jetë e mundur nga burgjet në vende të përshtatshme për këtë kategori personash”*.

Shënime paraprake

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës, trajtimin ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues, në vijim Mekanizmi Kombëtar (MKPT)⁵, pranë Avokatit të Popullit, dhe “Neni 81 i ligjit 81/2020 “Për trajtimin e të drejtave të dënuarve me burg dhe të paraburgosurve”, bazuar në nenin 19/1 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, kreu një inspektim në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale (I.E.V.P.) Krujë, më datë 30.08.2021, sipas Planit të Inspektimit të miratuar nga Avokati i Popullit. Në përbërje të grupit inspektues ishin znj. Nertila Qafzezi, z. Besnik Deda, z. Hazbi Selita dhe znj. Gloria Çarkaxhiu, me detyrë nd/komisionerë pranë Mekanizmit Kombëtar.

Avokati i Popullit në rolin e Mekanizmit Kombëtar, pasi u njoh me konstatimet e grupit inspektues, ka detyrimin kushtetues dhe ligjor t’ju parashtojë gjetjet përfundimtare, për situatën

⁵ Neni 81 i ligjit 81/2020 “Për trajtimin e të drejtave të dënuarve me burg dhe të paraburgosurve”.

në I.E.V.P. Zahari në momentin e inspektimit duke e gjykuar se do i vlejnjë punës suaj për të siguruar që situata të tilla mos të përsëriten më në të ardhmen.

I.E.V.P. Krujë është ndërtuar në vitin 1986 përshtatur fillimisht për të shërbyer si Spital Psikiatrik, por popullimi i saj me të dënuar ka vazhduar në vitin 2001, pasi kaloi në varësi të Ministrisë së Drejtësisë. Në vitin 2009 është kategorizuar si Institucion i Veçantë për shkak të kategorisë së personave me sëmundje të shëndetit mendor të akomoduar në I.E.V.P. (Shtetas të dënuar: moshë e tretë, paraplegjik, me probleme të shëndetit mendor, si dhe shtetas me masë mjekësore “Shtrim i Përkohshëm” “Mjekim i Detyruar”), popullohej kryesisht me persona që kanë këtë diagnozë.

Pavarësisht konstatimeve të bëra vazhdimisht, si dhe rekomandimeve të përsëritura të Avokatit të Popullit, organizatave ndërkombëtare të ngritura në mbështetje të Konventës Evropiane për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimin ose Dënimit Çnjerëzor ose Degradues (si p.sh. Komitetit kundër Torturës të Këshillit të Evropës CPT), organizatave jofitimprurëse që operojnë në vend (p.sh. Komiteti Shqiptar i Helsinkit KSHH, Shoqata Përthyerje, etj.), I.E.V.P. Krujë vazhdonte të mbetej në funksionim si Institucion i Veçantë Shëndetësor, ndonëse nuk plotësonte asnjë kriter apo standard për të funksionuar si i tillë. Urdhri Nr.8927⁶ datë 27.09.2018 “Për Klasifikimin e Institucioneve të Ekzekutimit të Vendimeve Penale” e ka klasifikuar Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale Krujë, si “Instituti i Veçantë” me seksion të posaçëm për të moshuar mbi 65 vjeç, me siguri të lartë dhe të zakonshme, një sektor të veçantë për të dënuarit me shqetësime psikike dhe të sëmurë të pamundur, me siguri të zakonshme.

Godina e Institucionit kishte nevojë urgjente për rikonstrukcion të mirëfilltë pasi ishte tepër e amortizuar. Aktualisht I.E.V.P. Zahari ndodhet në proces konservimi sipas urdhrin të Ministres së Drejtësisë, që në vitin 2018. Ky urdhër nuk ishte zbatuar dhe ajo në datë 20.11.2020 ka bërë me dije në Kuvendin e Shqipërisë se I.E.V.P Krujë në vitin 2021 do kalojë në rikonstrukcion⁷. Lidhur me këtë çështje Institucioni i Avokatit të Popullit konstatoi se ky institucion në kundërshtim me urdhrin Nr.8927/1 datë 27/09/2018, nuk kishte kaluar në gjendje konservimi pasi vetëm për vitin 2020 ka patur 102 persona të akomoduar rishtazi duke e çuar numrin total të personave të akomoduar aty në 293. Për vitin 2021 përgjatë inspektimit konstatoam se jo vetëm që nuk ishte ulur mbipopullimi por ka kaluar përtej çdo kapaciteti akomodues në 308 persona **duke vënë theksin se IEVP Krujë kapacitetin akomodues e ka për 196 persona.** Pra situata kishte vijuar të përkeqësohej nga viti 2018 deri në 2021.

Situata e pacientëve me masë mjekësore ndodhet në vazhdimësi në kushtet e shkeljes së të drejtave të njeriut:

⁶ Urdhri i Ministrisë së Drejtësisë Nr.8927 datë 27.09.2018 “Për Klasifikimin e Institucioneve të Ekzekutimit të Vendimeve Penale”

⁷ <https://www.drejtësia.gov.al/newsroom/fjalime/interpelanca-e-ministres-së-drejtësisë-për-situatën-në-burgje/>

- CPT⁸ ndër vite ka ngritur shqetësimin se situata e pacientëve me masë "mjekim i detyruar" në Shqipëri ka qenë subjekt i një dialogu të gjatë midis CPT-së dhe autoriteteve shqiptare. Në raportin për vizitën në Shkurt 2017, CPT shprehu shqetësim serioz megjithë rekomandimin specifik të bërë në mënyrë të përsëritur nga Komiteti që nga vizita e vitit 2000 dhe në kundërshtim me legjislacionin e brendshëm, pacientët me masë "mjekim i detyruar" vazhdojnë të mbahen në Spitalin e Burgut në Tiranë dhe në Institucionin e Veçantë të Zaharisë në Krujë në kushte të papranueshme^[1]. Në fakt, kushtet e jetesës në këto dy institucione ishin përkeqësuar më tej që nga vizita e vitit 2014 (në veçanti për sa i përket gjendjes së riparimit dhe mbipopullimit)^[2], dhe niveli i kujdesit psikiatrik mbetet qartë i pamjaftueshëm. Në përgjithësi, Komiteti krijoi përshtypjen e "braktisjes terapeutike" të shumë pacientëve.

Avokati i Popullit nëpërmjet Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës ka rekomanduar në mënyrë të përsëritur nevojën për mbylljen e Institucionit të Veçantë të Zaharisë në Krujë, por nga ana e institucioneve përgjegjëse nuk ishte adresuar kjo problematikë madje gjatë inspektimeve të kryera më tej ishte konstatuar një shtim i numrit të personave në këtë institucion.

Në përmbushje të detyrimit të tij kushtetues dhe ligjor, Avokati i Popullit parashtron gjetjet e bëra nga inspektimi në IEVP Krujë, duke ju referuar sa më poshtë vijon:

Nga informacioni, Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP) Krujë, është kategorizuar si Institut i Veçantë i sigurisë së lartë e të zakonshme, me një seksion me të dënuar mbi 65 vjeç, një seksion me të sëmurë kronikë dhe persona me aftësi të kufizuar, një seksion me persona me çrregullime të shëndetit mendor dhe një seksion paraburgimi, me kapacitet akomodues prej **196 personash**.

Në ditën e raportimit, në mjediset e institucionit ndodheshin **308 persona**. Institucioni ishte i ndarë në dy sektorë A dhe B. Shtetasit me masë mjekësore janë vendosur në sektorin A, në katin e parë të sektorit B si dhe në gjysmën e katit të dytë të sektorit B, ndërsa të dënuarit janë të vendosur në gjysmën tjetër të katit të dytë të sektorit B. Në këtë institucion ndodheshin 196 persona me mjekim të detyruar, 96 persona me shtrim të përkohshëm dhe 16 persona të dënuar.

Struktura dhe organika e institucionit përbëhej nga 149 punonjës, prej të cilëve 112 punonjës të sigurisë dhe rolit bazë dhe 37 punonjës civilë. Nga inspektimi rezultoi se institucioni nuk kishte kaluar në konservim sipas Urdhrit të Ministres së Drejtësisë Nr.8927 datë 27.09.2018 në të kundërt, u konstatua se situata ishte rënduar edhe më tej nga mbipopullimi i vazhdueshëm me mbi 100 persona mbi kapacitet dhe mungesa e investimeve.

Organika⁹ në I.E.V.P. Krujë nuk ishte e plotësuar dhe ka mungesa në staf. Konkretisht:

⁸ Në raportin më të fundit të publikuar nga CPT mbi vizitën e kryer në nëntor të vitit 2018

⁹ Organika ka mbetur e pandryshuar megjithëse e ndryshuar ka 50% të personave të akomoduar mbi kapacitetin zyrtar.

1 mjek (vend vakant)
2 mjekë (part time);
1 farmacist;
1psikolog

Mungesa e stafit të lartpërmendur, veçanërisht mungesa në mjek, ishte kambanë alarmi mbi respektimin e të drejtave të njeriut. ***Theksojmë se për 308 persona të diagnostikuar me probleme të shëndetit mendor në IEVP Krujë në detyrë ndodhet vetëm një mjek psikiatër që e bën krejt të pa përshtatshëm shërbimin shëndetësor për ta.*** Kjo mungesë ka ndikuar në vijueshmërinë e punës dhe ofrimit të shërbimeve ndaj shtetasve të akomoduar në institucion. Mungesa e shtimit të kapaciteteve mjekësore në kushtet e një mbipopullimi të theksuar, kishte nevojë imediate për shtimin në organikë të stafit mjekësor.

Neglizhenca terapeutike ishte një problem i evidentuar ndër vite që ishte i papranueshëm. Evident ishte fakti që nuk ka interes nga mjekët për të ushtruar detyrën pranë këtij institucioni ndaj duheshin parashikuar masa konkrete për bonuse shtesë për ata që ushtronin detyrën pranë këtij institucioni.

Një nga qëndrimet e CPT¹⁰ parashikon se “derisa qëndrojnë në burg, personave të dënuar duhet t’u mundësohet qasja te mjeku në çdo kohë, pa marrë parasysh faktin e regjimit të burgosjes së tyre” dhe se “shërbimi shëndetësor duhet të organizohet në mënyrë, që të mundësojë që kërkesat për konsultime mjekësore të ofrohen pa zgjatje të pa nevojshme”.

Mungesa e psikologut në institucion ndërkohë që në IEVP Krujë ishin të akomoduar numri më i madh i shtetasve me çrregullime të shëndetit mendor, ishte shqetësuese, vakancë e cila kishte shkaktuar mbingarkesë për punonjësit e tjerë të stafit psiko-social. Mungesat në stafin psiko-social ndikonte drejtpërdrejtë në cilësinë e shërbimit psikologjik dhe social ndaj të paraburgosurve/dënuarve, si dhe nuk mundësonte rehabilitimin e tyre. Në mënyrë të veçantë kjo situatë ishte e ndjeshme për shërbimin e domosdoshëm që kërkonin të sëmuret me çrregullime të shëndetit mendor.

Grupi inspektimit, gjatë vizitës kërkoi të informohet në veçanti edhe mbi masat e marra nga ana e këtij institucioni, për parandalimin e sëmundjes infektive Covid-19¹¹. Nga informacioni i mbledhur dhe nga këqyrja në ambientet e I.E.V.P Krujë rezultoi se ishte zbatuar protokolle shtesë i shëndetësisë për masat anti-Covid-19, në kuadrin e pandemisë si më poshtë:

- Çdo ditë, stafit të institucionit i ushtrohej kontrolli për matjen e temperaturës para hyrjes në institucion, si dhe pajiseshin me maska dhe doreza.

¹⁰ <https://www.coe.int/en/web/cpt/-/council-of-europe-anti-torture-committee-publishes-albanian-response-to-the-report-on-the-2018-visit>

¹¹ “Akte ligjore për COVID-19” (Përditësuar datë 30.12.2020 FZ Nr. 234)
<https://qbz.gov.al/news/33b00e4f-8efb-4c99-8c45-595cd9b84f1b>

- I gjithë personeli zbatonte me korrektesë masat mbrojtëse dhe dezinfektuese, duke pasur një vëmendje të shtuar në ambientet e punës me mbajtjen e maskave, përdorimin e dezinfektantëve që ndodheshin në ambientet e përbashkëta por dhe duke ruajtur distancimin social dhe higjienën personale.
- Ishin shmangur ose minimizuar grumbullimet e stafit, mbledhjet dhe kontaktet me të tretë.
- Urdhrat, udhëzimet dhe protokollat shtesë të Ministrisë së Shëndetësisë, ishin afishuar në hyrje të institucionit, si dhe në hyrje të çdo pavijoni.
- Për rastet e punonjësve, kur kishin rezultuar pozitiv ishin karantinuar menjëherë në banesat e tyre, si dhe personat e kontaktit të afërt me ta ishin larguar nga puna për periudhën e karantinimit, duke shmangur çdo mundësi të përhapjes së mëtejshme të infektimit.
- Dezinfektimi ishte kryer në mënyrë periodike në të gjitha ambientet e brendshme dhe të jashtme të institucionit.

Nga sa më lart, u konstatua se rekomandimet e bëra nga Avokati i Popullit në inspektimet e mëparshëm, konkretisht situata paraqitet si më poshtë:

Rekomandimet e Avokatit që kanë gjetur zbatim:

- Ishin marrë masa për pajisjen e institucionit me Autoambulancë të re;
- Ishin marrë masa për pajisjen e dhomës së stomatologut me unit të ri;
- Ishin marrë masa për vënien në funksion të plotë të skemës së furnizimit me ilaçe.

Përgjatë inspektimit rikonstatojm se rekomandimet e Avokatit të Popullit nuk kanë gjetur zbatim dhe situata paraqitet si më poshtë:

Infrastruktura ishte tejet e amortizuar krahas amortizimit të pajisjeve të mangëta në dhoma, lagështia si rrjedhojë e problemeve me hidroizolimin, mungesa e sistemit të ngrohjes dhe e sistemit të ajrosjes, e bëjnë tepër të vështirë jetesën në këtë institucion. Shumë problematike paraqitet situata në pjesët lidhëse midis godinës së administratës dhe regjimit të brendshëm, si dhe ndërmjet sektorit A dhe sektorit B, pasi në këto pjesë, uji dhe lagështia kanë depërtuar në ambientet e poshtme të banimit në ndërtesë.

Mungesa e investimeve në riparime dhe materiale mbështetëse në të gjitha ambientet e regjimit të brendshëm. Brenda dhomave kishte prani të theksuar të lagështirës dhe të mykut, mure të plasaritura dhe të palyera, papastërti e theksuar dhe prani e dukshme e insekteve, brejtësve dhe zvarranikëve. Personat paraplegjikë hasnin vështirësi në përmbushjen e nevojave të higjienës veçanërisht në tualete e dushe, si pasojë e pamjaftueshmërisë së kujdestarëve si dhe e pamjaftueshmërisë së rampave. Në përgjithësi përmbushja e kushteve për higjienë personale ishte

e vështirë për t'u realizuar për shkak të numrit të madh të personave në raport me katër tualetet në sektor.

Në dhoma me sipërfaqe 12 metra katrorë strehoheshin 8 deri në 10 persona me mjekim të detyruar apo të dënuar, në kundërshtim me standardet minimale të pranuar nga Këshilli i Evropës përcakton se çdo i dënuar duhet të ketë 4-6 metra katrorë (ose 9 metra kub) hapësirë në dhomë.

I.E.V.P. Krujë nuk kishte sistem ngrohjeje dhe të dënuarit me probleme të shëndetit mendor nuk lejoheshin të mbanin mjete ngrohëse nëpër dhoma, çka përbënte rrezik për jetën e tyre dhe të të tjerëve.

I.E.V.P. Krujë jo vetëm që nuk mund të garantonte lëvizjet e pacientëve drejt spitaleve, apo të të paraburgosurve/dënuarve drejt gjykatave etj., por as transportin e sigurt të stafit, duke vështirësuar tej mase edhe kontaktet e familjarëve me personat që mbaheshin e trajtoheshin në të. Rruga në shpat mali që lidh I EVP Krujë me qytetin, ishte tejet e amortizuar dhe nuk mundësonte as shkëmbimin e makinave në pjesën më të madhe të saj, duke u bërë vështirësish e kalueshme në rastet e kushteve të rënduara të motit.

Aksesi në tualet si një element tepër i rëndësishëm në vetë higjienizimin e personave me çrregullime të shëndetit mendor ishte i vështirë për t'u realizuar dhe i vonuar, në I.E.V.P. Krujë për shkak të numrit të lartë të pacientëve në raport me 4 tualete, të organizuar në 2 kate. Vlen të theksohet se tualeti i cili përdorej nga pacientët me gjendje të agravuar të shëndetit mendor, në këtë institucion, ishte në kushte të pa tolerueshme duke krijuar rrethana për trajtim çnjerëzor dhe degradues.

Në mungesë të njësisë tregëtare dhe të arkës në institucion, nevojat për blerje të artikujve të ndryshëm nga ana e personave të privuar nga liria mbeteshin të pa plotësuar.

Organizimi i aktiviteteve të nevojshme rehabilituese ishte i vështirë, i pamundur, si pasojë e mungesës së ambienteve të përshtatshme për mundësimin e tyre. Aktiviteti punonjësve të Sektorit të Kujdesit Social kufizohej vetëm në këshillime individuale apo biseda për tema të lira në ambientet e ajrosjes çka reflektonte një mungesë të trajtimit të posaçëm dhe rehabilitues, dhe mundësia që këta shtetas të kenë përmirësim shëndetësor të gjendjes së tyre mendore ishte pakësuar.

Në kushtet e një trajtimi çnjerëzor dhe degradues ishte dhe “Klasa” e cila duhej të përdorej për këshillim dhe riintegrim të personave që ndodhen në këtë institucion, për shkak të mbipopullimit ajo ishte kthyer në ambient banimi ku në të ishin akomoduar 21 persona me probleme të theksuara të shëndetit mendor. Ky ambient kishte një mungesë të theksuar higjienë dhe një ambient tepër të rënduar. Kjo situatë e mbipopulluar vërehej edhe në sektorë dhe ambiente të tjera ku dhomat ishin me nga 10-12 persona.

Praktika botërore por edhe kuadri ligjor Shqiptar i mëshon politikave lehtësuese dhe mbështetëse për shërbimet e shëndetit mendor, duke vendosur prioritete strategjike që lidhen me trajtimin, ndjekjen, trajtimin spitalor të këtyre pacientëve (shërbimet e shëndetit mendor) në krahasim me shërbimet e kujdesit shëndetësor në tërësi. Për këtë ndërhyrje të rëndësishme, strukturat qeverisëse duhet të krijojnë hapësira për zgjerimin e mbështetjes dhe garantimit të prioriteteve ndaj këtij shërbimi mjekësor për të garantuar mirëfunksionimin e çdo strukture apo specialiteti. Në rastin Strazimiri kundër Shqipërisë (kërkesa nr. 34602/16) Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut njëzëri ka gjetur se ka pasur¹²:

- Shkelje e Nenit 3 (ndalimi i trajtimit çnjerëzor ose degradues) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut për shkak të kushteve joadekuate të jetesës në spitalin e burgut, ku kërkuesi u mbajt në paraburgim dhe kujdes të pamjaftueshëm psikiatrik
- Shkelje të Nenit 5 të Konventës Evropiane (e drejta për liri dhe e siguri), në veçanti për shkak të privimit të vazhdueshëm të lirisë në burg në vend të një institucioni mjekësor dhe për shkak se ankesa e tij kundër ndalimit ishte në pritje përpara Gjykatës Supreme që nga viti 2016.

Gjykata konstatoi në veçanti se autoritetet shqiptare kishin dështuar në afat të gjatë për të ndërtuar një institucion të posaçëm mjekësor për të sëmurët mendorë të cilët ishin privuar nga liria në fuqinë e trajtimit të detyrueshëm të urdhëruar nga gjykata. Kjo ishte në kundërshtim me detyrimet e saj ligjore të brendshme dhe përbënte problem strukturor.

Gjykata gjithashtu konsideroi se Shqipëria duhet të marrë masa sa më shpejt që të jetë e mundur për të siguruar kushte të përshtatshme jetese dhe mjedis të duhur shëndetësor për personat e sëmurë mendorë që i nënshtrohen privimit të lirisë për shkak të gjykatave që urdhërojnë trajtimin e tyre të detyrueshëm mjekësor. Masat e tilla duhet të përfshijnë ose rinovimin e objekteve ekzistuese ose krijimin e objekteve të reja të specializuara, qëllimi i të cilave ishte shërimi ose zbutja e problemeve mendore të të ndaluarve, zvogëlimi i rrezikshmërisë së tyre dhe lehtësimi i reintegrimit të tyre në shoqëri. Në fund, autoritetet duhet të rekrutojnë mjaft punëtorë të kualifikuar të kujdesit shëndetësor mendor në mjedise të tilla dhe të konsiderojnë, aty ku është e përshtatshme, mundësinë e trajtimit ambulant.

Avokati i Popullit rekomandon që me mbylljen e I.E.V.P. Zahari të bëhet një vlerësim i situatës terapeutike të të gjithë personave që do të trajtohen në dy godinat e I.E.V.P. Shën Koll. Shqetësim mbetet kapaciteti i I.E.V.P. Shën koll i cili ka kapacitet vetëm për 112 persona që janë akomoduar në I.E.V.P Zahari.

¹² <http://www.avokaturashetit.gov.al/vendimet-e-strasburgut/vendimet-e-gjykes-evropiane-per-te-drejtave-te-njeriut-strasburg>

Trajtimi

Grupi i inspektimit, kishte për qëllim mbledhjen e informacionit lidhur me garantimin e të drejtave dhe trajtimin e personave që vuajnë dënimin në këtë institucion, identifikimin e rasteve të dhunës, përdorimin e forcës fizike tej kufijve të parashikuar me akte normative apo ushtrimin të presionit psikologjik ndaj kësaj kategorie, mënyrën e trajtimit dhe zgjidhjes së kërkesë/ankesave të të burgosurve, procedurat që ndiqen nga komisioni për pritjen e tyre në institucion, komisioni për dhënien e masave disiplinore, aktivitetet e zhvilluara, trajtimin shëndetësor të të dënuarve, cilësia e ushqimit, furnizimi sipas normativave me detergjente dhe mjete të higjienës personale, etj.

Në regjimin e brendshëm pranë dhomës së këshillimeve, Sektori i Çështjeve Shoqërore dispononte një dosje të veçantë, ku përmban kërkesa dhe ankesa me objekte të ndryshme.

Gjatë kësaj periudhe në I.E.V.P Krujë, pranë Sektorit të Çështjeve Shoqërore, nuk ishte paraqitur asnjë ankesë, ndërsa sa i përket kërkesave ato kanë qenë të natyrës:

- blerje të pajisjeve elektrike për të dënuarit;
- kërkesa për komunikim me skype;
- telefonata shtesë.

Të gjitha kërkesë-ankesat pasi administroheshin nga sektori social, përcilleshin për njohje dhe siglim nga ana e titullarit të institucionit dhe më pas i kalonin për veprim përgjegjësve të sektorëve me afate të përcaktuara, në bazë edhe të natyrës së kërkesës.

Prej dt.14. 06. 2021 kishin rifilluar takimet me familjarët kjo sipas Urdhrit të Ministrisë së Drejtësisë Nr.6285/1 datë 11.06.2021 *“Për zbatimin e masave për parandalimin e përhapjes së infeksionit të shkaktuar nga Covid-19 në institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale”*.

E drejta për të mbajtur kontakte me familjarët zbatohet përgjithësisht sipas rregullores. Takimet fizike me familjarët zhvilloheshin një herë në muaj, gjithashtu takimet realizoheshin edhe nëpërmjet komunikimit me platformën online “skype” mesatarisht rreth 4 herë në muaj dhe takimi me familjarët zgjaste rreth 30 minuta. Gjithashtu aparatet telefonik me kartë janë të vendosur në mjediset e regjimit të brendshëm në çdo sektor. Ata janë në gjendje pune dhe konfirmua se respektohet numri i 8 telefonatave në muaj me familjet dhe të afërmit e tyre. Në IEVP Zahari nuk ka patur raste infektimi covid-19, në këtë institucion janë vaksinuar 276 pacientë me një dozë dhe me dozën e dytë 10 pacientë.

Për sa më sipër dhe në mbështetje të pikës 3, të nenit, 63 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku thuhet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”*; të nenit 21, germa “b” të ligjit nr. 8454 dt. 04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”*, i ndryshuar, ku thuhet se: *“Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi*

administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive; si dhe në bazë të nenit 81, pika 2/b të ligjit Nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, ku parashikohet midis të tjerash se: “Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës ka këto kompetenca:

b) paraqet rekomandime për organet përkatëse, me qëllim që të përmirësohen trajtimi dhe kushtet e individëve që u është hequr liria dhe të parandalohet tortura, trajtimi ose dënimi i egër, çnjerëzor ose poshtërues.”.

REKOMANDOJMË:

1. Pas mbylljes së I.E.V.P. Zahari të bëhet një vlerësim i situatës terapeutike të të gjithë personave që do të trajtohen në dy godinat e I.E.V.P. Shën Koll.
2. Marrjen e masave të menjëhershme për rivlerësimin e organikës dhe plotësimin e saj në staf mjekësor dhe staf social të mjaftueshëm në proporcion me numrin e personave që janë akomoduar në dy godinat e I.E.V.P. Shën Koll për një trajtim sa më dinjitoz të personave me probleme të shëndetit mendor.
3. Marrjen e masave që personat me masë mjekësore që janë akomoduar në I.E.V.P. Shën Koll të kenë akses në shërbime të specializuara shëndetësore, të cilat mundësohen nga shërbimet mjekësore të ambulancave/spitaleve shtetërore.
4. Të merren masat për ndërtimin e një spitali të mirëfillte forensik në Shqipëri.

Për qëndrimin dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, të vihemi në dijeni brenda afatit 30 ditor sipas nenit 22 të Ligjit Nr. 8454 dt. 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj.

AVOKATI I POPULLIT

ERINDA BALLANCA